

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-112/11

Prishtinë, 8 mars 2012

Në procedurën e:

**A.A.**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

Kundër

**S.A.**

*Pala përgjegjëse në ankesë/Pala përgjegjëse në kërkesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/102/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrat. KPA42422, KPA42423, KPA42424, KPA42425, KPA42426, KPA42427, KPA42428, KPA42429, KPA42430, KPA42432, KPA42433, KPA42434, KPA42435, KPA42436, KPA42437, KPA42438, KPA42439, KPA43337, KPA43338, KPA43339, KPA43340, KPA43341, KPA43342, KPA43347, KPA43348, KPA43349, KPA43350, KPA43351, KPA43352, KPA43353 dhe KPA43355, të datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 8 mars 2012, mori këtë:

## JUDGMENT

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e A.A..
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/102/2011, i datës 23 shkurt 2011, për sa i përket lëndëve të regjistruara me numrat KPA42422, KPA42423, KPA42424, KPA42425, KPA42426, KPA42427, KPA42428, KPA42429, KPA42430, KPA42432, KPA42433, KPA42434, KPA42435, KPA42436, KPA42437, KPA42438, KPA42439, KPA43337, KPA43338, KPA43339, KPA43340, KPA43341, KPA43342, KPA43347, KPA43348, KPA43349, KPA43350, KPA43351, KPA43352, KPA43353 dhe KPA43355.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 530 (pesëqind e pesëdhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 26 dhe 27 nëntor 2007, A.A. ka paraqitur disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte që të njëjti si pronar i ngastrave të ndryshme tokës të fituara me anë të trashëgimisë dhe ka kërkuar ri-posedimin e tyre. Ai ka theksuar se babai i tij i ndjerë ishte pronar i pronës në pjesën prej ¼. Ai ka sqaruar se ngastrat i përkisnin gjyshit të tij të ndjerë A.A. dhe se axha i tij D.A. e kishte regjistruar vetën në mënyrë të paligjshme si pronar të tërë pronës në vitin 1984.

Në formularët e kërkesës të nënshkruara nga paraqitësi i kërkesës, paraqitësi i kërkesës thekson se babai i tij i ndjerë (M.A.) ishte bashkëpronar i ngastrës së përmendur kadastrale, e cila ishte uzurpuar nga axha i tij D.A. dhe paraqitësi i kërkesës kërkon ri-posedimin e ngastrës dhe kompensim për shfrytëzimin e saj. Formularët e kërkesës të nënshkruar nga paraqitësi i kërkesës, lidhur me GSK-KPA-113/11 (KPA42423) theksojnë si në

vijim: “Duke nënshkruar këtë formular të kërkesës, paraqitësi i kërkesës vërteton se e drejta e tij pronësore ka të bëjë me pronën e paluajtshme private e cila është humbur si rezultat i rrethanave të vitit 98/99 në Kosovë dhe thekson se data e humbjes është 15/06/1999”. Në kërkesat tjera në fjalë, paraqitësi i kërkesës ka nënshkruar kërkesat me datën e humbjes 10 maj 1999.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:

- Aktgjykimin C.nr.1181/89, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prizrenit me 3 nëntor 1989, me të cilin është anuluar kontrata e dhurimit VR.nr. 1766/64 mbi pronën e paluajtshme të lidhur ndërmjet babait të paraqitësit të kërkesës, M.A., axhës së paraqitësit të kërkesës, D.A., babait të palës përgjegjëse në kërkesë;
- Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.103/90 i datës 26 shkurt 1990, me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit D.A. dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.1181/89 i datës 3 nëntor 1989 është vërtetuar;
- Aktvendim gjyqësor me numër të referencës Rev. 3253/93 të lëshuar nga Gjykata Supreme në Beograd me 6 tetor 1993, me të cilin është hedhur si i paluejueshëm revizioni i të paditurve G.A. dhe A.A. të paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr.1181/89 ku kundërshtohet revizion në lëndën e G.A. he paditësit D.A.;
- Certifikatën e lindjes së A.A., i lindur me 6 janar 1956 si i biri i M.A. dhe nga nëna G.A. e gjinisë D., të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e Banjës së Nishit, Zyra e vendit Jelasnica, me 18 korrik 2005;
- Fletën poseduese nr.. 24, të lëshuar nga Republika e Serbisë-SGP Kosova e Metohija, Komuna e Prizrenit, komuna kadastrale e Jabllanicës, me 22 dhjetor 1998.

Fleta poseduese nr. 24 ka treguar se babai i palës përgjegjëse në kërkesë, D.A., është bartës i së drejtës pronësore. Kjo pronë është si në vijim:

Numri i ankesës dhe lëndës në AKP	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-112/11 (KPA42422)	Ngastra. 1134, në komunën e Prizrenit në Pousko-Jabllanice, zona kadastrale e Jabllanicës, kopsht i klasës me sipërfaqe prej 13 ari e 52 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-113/11 (KPA42423)	Ngastra nr. 1152, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, shtëpi 1 katëshe me bodrum (1 kat, 4 dhoma), 2 ari e 21m <sup>2</sup> , oborri me sipërfaqe prej 5 ari,

GSK-KPA-A-114/11 (KPA42424)	Ngastra nr. 1152, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 5 arie e 86m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-115/11 (KPA43349)	Ngastra nr. 1825, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Porodin-Nurtova kosara, arë e klasës 7 kullosë me sipërfaqe prej 2 ari, 72 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-116/11 (KPA424226)	Ngastra nr. 1154, në komunën e Prizrenit, Jabllanicë, vendi Markov rit, 7. livadh i klasës 7 me sipërfaqe prej 2 ari e 19m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-117/11 (KPA42427)	Ngastra nr. 1154, në komunën e Prizrenit, Jabllanicë, vendi Markov rit, kullosës e klasës 5 me sipërfaqe prej 80 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-118/11 (KPA42428)	Ngastra nr. 1155, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, shtëpi 1 katëshe me podrum
GSK-KPA-A-119/11 (KPA42429)	Ngastra nr. 1156, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, (palexueshëm) i klasës 5 me sipërfaqe prej 4ar, 79m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-120/11 (KPA42430)	Ngastra nr. 1157, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, 6. class field me sipërfaqe prej 25ar, 14 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-121/11 (KPA42432)	Ngastra nr. 1158, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, livadh i klasës 6 me sipërfaqe prej 23 ari 34 m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-122/11 (KPA42433)	Ngastra nr. 1159, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, 6. kopsht i klasës 6 me sipërfaqe prej 8 ari e 83m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-123/11 (KPA42434)	Ngastra nr. 1160, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, mal i klasës 5 me sipërfaqe prej 19ari e 55m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-124/11 (KPA42435)	Ngastra nr. 1177, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, kullosë e klasës 7 me sipërfaqe prej 21ari e 64m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-125/11 (KPA42436)	Ngastra nr. 1178, në komunën e Prizrenit, Pousko, vendi Markov rit, livadh i klasës 8 me sipërfaqe 6 ari e 71m <sup>2</sup>

GSK-KPA-A-126/11 (KPA42437)	Ngastra nr. 1207, në komunën e Prizrenit, Pousko, Pokrojenik M. rit, mal i klasës 5 me sipërfaqe prej 43 ari e 56m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-127/11 (KPA42438)	Ngastra nr. 1208, në komunën e Prizrenit, Pousko, Pokrojenik M. rit, livadh i klasës 7 me sipërfaqe prej 63 ari e 23m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-128/11 (KPA42439)	Ngastra nr. 1287, në komunën e Prizrenit, Pousko, Pokrojenik M. rit, male i klasës 4 me sipërfaqe prej 16 ari e 30m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-129/11 (KPA43337)	Ngastra nr. 1176, në komunën e Prizrenit, Pousko, Markov rit, mal i klasës 7 me sipërfaqe prej 9 ari e 5m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-130/11 (KPA43338)	Ngastra nr. 1175 në komunën e Prizrenit, Pousko, Markov rit, mal i klasës 7 me sipërfaqe prej 14 ari e 32m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-131/11 (KPA43339)	Ngastra nr. 1174, në komunën e Prizrenit, Pousko, Markov rit, kullosë e klasës 7 me sipërfaqe prej 32 ari e 43m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-132/11 (KPA43340)	Ngastra nr. 1173, në komunën e Prizrenit, Pousko, Markov rit, arë e klasës 8 me sipërfaqe prej 8 ari e 36m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-133/11 (KPA43341)	Ngastra nr. 1162, në komunën e Prizrenit, Pousko, Markov rit, vresht e klasës me sipërfaqe prej 8 ari e 18m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-134/11 (KPA43342)	Ngastra nr. 1161, në komunën e Prizrenit, Pousko, Markov rit, arë e klasës 6 me sipërfaqe prej 40 ari e 88m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-135/11 (KPA43347)	Ngastra nr. 2732, në komunën e Prizrenit, Pousko, malë i klasës së 5-të me sipërfaqe prej 12 ari e 25m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-136/11 (KPA43348)	Ngastra nr. 1827, në komunën e Prizrenit, Pousko, Jablanica, livadh i klasës 1 me sipërfaqe prej 2 ari e 26m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-137/11 (KPA42425)	Ngastra nr. 1153, në komunë e Prizrenit, Pousko, Markov rit, kopsht i klasës 6 me sipërfaqe prej 3 ari e 89m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-138/11	Ngastra nr. 1484, në komunën e Prizrenit, Pousko, Isakovo-(e

(KPA43350)	palexueshme), kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 7ari e 6m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-139/11 (KPA43351)	Ngastra nr. 1483, në komunën e Prizrenit, Pousko, Isakovo-(e palexueshme), arë e klasës 8 me sipërfaqe prej 56 ari e 10m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-140/11 (KPA43352)	Ngastra nr. 1375, në komunën e Prizrenit Pousko, Kora-potok, Belavoda, arë e klasës 8 me sipërfaqe prej 39 ari e 78m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-141/11 (KPA43353)	Ngastra nr. 1482, në komunën e Prizrenit, Pousko, Isakovo-(e palexueshme), mal i klasës 6 me sipërfaqe prej 5 ari e 91m <sup>2</sup>
GSK-KPA-A-142/11 (KPA43355)	Ngastra nr. 1288, në komunën e Prizrenit, Pousko, Pokrojenik, livadh i klasës 6 me sipërfaqe prej 7 arri e 95m <sup>2</sup>

Fleta e paraqitur poseduese nr.. 24 ishte verifikuar. Në vitin 2007, ishte djegur i tërë Drejtorati për Kadastër në Prizren dhe shënimet, prandaj nuk është e mundur që të sigurohen informata tjera lidhur me historikun e pronës.

Aktgjykimi C.nr.1181/89 i lëshuar nga Gjykata Komunale e Prizrenit me 3 nëntor 1989 dhe aktgjykimin gjyqësor Ac.nr.103/90 i lëshuar nga Gjykata e Qarkut e Prizrenit me 26 shkurt 1990 janë verifikuar. Po ashtu është verifikuar aktgjykimi me numër të referencës Rev. 3253/93 i lëshuar nga Gjykata Supreme në Beograd me 6 tetor 1993.

Nëna e paraqitësit të kërkesës G.A. kishte iniciuar procedurën e trashëgimisë në Gjykatën Komunale të Prizrenit në lidhje me kërkesat e bashkëshortit të saj. Gjykata e kishte hedhur poshtë kërkesën si të paafatshme. Kundërshtime të ndryshme janë bërë nga familja e paraqitësit të kërkesës sa i përket vendimit mbi trashëgiminë të Gjykatës Komunale të Prizrenit duke përfshirë ankesat në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe në Gjykatën Supreme të Beogradit e cila kishte nxjerrë aktgjykimin Rev. 3253/93 duke mbështetur ankesën kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Prizren. Paraqitësit e kërkesës kanë kërkuar bashkëpronësinë e pronës së kontestueshme. Veprime tjera gjyqësore në kundërshtim të vendimit ligjor mbi trashëgiminë janë iniciuar në vitin 1994 dhe në vitin 1998.

Në vitin 2008, ekipi për njoftim i AKP-së ka shkuar në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kontestuara dhe kishte vendosur shenja që tregonin se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhej të paraqisnin përgjigjen e tyre brenda 30 ditëve. E tërë prona është gjetur e uzurpuar nga S.A. i cili ka

pretenduar të drejtën pronësore mbi pronën në fjalë. Njoftimi është kontrolluar me anë të GPS-it dhe ortofotografive me vonë gjatë procedurës në vitin 2010 dhe është gjetur të ketë qenë i saktë. Vetën në lëndën GSK-KPA-A-142/11 (KPA43355) nuk ka ortofotografi në dokumente.

Me 23 shkurt 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e vet KPKK/D/A/102/201,1 i ka hedhur poshtë kërkesat pasi që ato nuk binin në juridiksionin e KKPK-së. Nën nr. 51 vendimin thekson si në vijim: “Komisioni konstaton se kontesti pronësor në këto kërkesa është rezultat i një kontesti familjar prej një kohe të gjatë dhe nuk ndërlidhet aspak me konfliktin në Kosovë të 1998-199. Vërehet se kontesti ka filluar mjaft kohë para konfliktit dhe ka vazhduar midis kontestuesve pas konfliktit. Paraqitësi i kërkesës deklaron se as ai e as babai i tij nuk kanë pasur kurrë posedimin e pronave të kërkuara dhe pajtohet se pronat janë shfrytëzuar vazhdimisht nga familja e palës përgjegjëse. Pala përgjegjëse konfirmon se familja e tij ka pasur posedimin e pandërprerë të pronave. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.” Vendimi ankimor i KPPK-ës i mbështetur në nenin 11.4 nënparagrafi (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-079 kur është shpallur inkompetent është ligjshëm.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesave me 29 qershor 2011. Me 22 korrik 2011, paraqitësi i kërkesave (me tutje në tekst: pala ankuese) ka paraqitur një ankesë në Gjykatë Suprem, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së mbi bazë të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Në ankesën e tij pala ankuese e ka konsideruar vendimin e KKPK-së si pjesërisht të saktë, pasi që ekziston kontesti i vjetër familjar në fjalë por e ka konsideruar atë më tej të pasaktë pasi që konflikti nuk ka qenë i ndërlidhur me konfliktin në Kosovë në vitin 1998/99. Pala ankuese e pranon se konflikti rreth pronës ka vazhduar qysh para vitit 1999 gjë që është treguar në kërkesën për trashëgimi të vitit 1993. Para kësaj, ky kontekst ka qenë kontekst rreth kontratës së dhurimit e cila ishte anuluar në vitin 1989. Paraqitësi i kërkesave po ashtu deklaron se qysh në vitin 1984, axha i tij e kishte regjistruar në mënyrë të paligjshme vetën si pronar të pronës. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës pohon se humbja e pronës ndërlidhet me konfliktin e vitit 1998/1999 pasi që procedura nuk ka mundur të përfundohej para konfliktit të vitit 1998/1999 dhe për shkak se madje edhe tani nuk ekzistojnë kushtet për përfundimin e tij brenda periudhës së paraparë ligjore me anë të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm. Pala ankuese deklaron se vendimi i KKPK-së përmban disa pasaktësi të paraqesin arsye për të anuluar këtë vendim. Ai deklaron se “kur bëhet krahasimi i sipërfaqës së ngastrave të tokës sipas numrit të njëjtë, ekzistojnë ndryshime në vendimin e KKPK-së dhe në fletën poseduese”. Megjithatë, pala ankuese nuk i specifikon këto pasaktësi të pretenduara.

Pala ankuese kërkon që të priset vendimi i KKPK-së dhe të pranohet kërkesat e tij.

Pala përgjegjëse në kërkesë (me tutje në tekst: pala përgjegjëse në ankesë) kërkon që të refuzohet ankesa dhe të konfirmohet vendimi i KKPK-së shkallës së parë.

Sipas mendimit të tij, vendimi i KKPK-së është i saktë. Pala përgjegjëse në ankesë më tej sqaron se paraardhësi i palës ankuese kishte hequr dorë nga ¼ e së drejtës së tij mbi pronën e paluajtshme në vitin 1964 për të cilën ai kishte pasur të drejtë në shkëmbim të shtesave për fëmijët e tij dhe me lidhjen e kontratës mbi dhurimin.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

### **Arsyetim ligjor:**

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe gjykata nuk gjen se ka pasur as vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe as zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Lëndët nuk janë në kuadër të juridiksionit të KKPK-së.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai apo ajo nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurti 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, paraqitësi i kërkesës në këtë rast nuk ka vërtetuar se është i kufizuar në ushtrimin e të drejtave të kërkuara pronësore për shkak të konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999. Ngastrat ishin regjistruar në emër të axhës së paraqitësit të kërkesës qysh në vitin 1984. Kontesti se kush është pronar i ngastrave, paraqitësi i kërkesës apo pala përgjegjëse në kërkesë, daton së paku qysh nga vitit 1989, kur është nxjerrë vendimi mbi trashëgiminë i Gjykatës Komunale të Prizrenit në lidhje me ngastrat kontestuese. Vendimet pasuese tregojnë se ka vazhduar kontesti brenda familjes. Ky kontest, dhe këtu gjykata pajtohet plotësisht me KKPK-në, nuk ka të bëjë asgjë me konfliktin në Kosovë gjatë viteve 1998/1999. Prandaj, humbja e pronës, që është pasojë e



kontestit familjar, nuk ka të bëjë me konfliktin e armatosur. Komisioni dhe Kolegji i Apelit të AKP-ës ka juridiksion vetëm për lëndët që kanë lidhshmëri me konfliktin siç është parashikuar me dispozitat e Nenit 3.1 nënparagrafi (a) dhe (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-79.

Se nëna e paraqitësit të kërkesës pretendohet të jetë larguar nga Kosova në vitin 1999 për shkak të presionit dhe kërcënimit pasi që ajo ishte e martuar me një mysliman dhe ishte e përkatësisë etnike serbe, nuk dëshmon se prona ishte humbur për shkak të konfliktit, pasi që prona ishte regjistruar në emër të axhës së paraqitësit të kërkesës shumë kohë më parë – dhe kontesti kishte lindur më herët – dhe se nuk ka ndonjë tregues se nëna e paraqitësit të kërkesës kishte jetuar në pronën kontestuese para se të largohej nga Kosova. I njëjti arsyetim vlen edhe për paraqitësin e kërkesës, i cili është larguar nga Kosova qysh para se të fillonte konflikti dhe kishte punuar në Gornji Milanovac derisa është pensionuar.

Pretendimi i paraqitësit të kërkesës se në këtë moment dhe në një të ardhme të parashikuar nuk do të ketë një gjyqësor efikas dhe të paanshëm që do të jetë në gjendje të zgjidh kërkesën e tij në Kosovë, as nuk i ndryshon faktet të cilat duhet të kihet parasysh nga gjykata e as nuk ndikon në karakterin e kërkesës së tij, e cila bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe në këtë mënyrë edhe jashtë juridiksionit të Kolegjit të Apelit të AKP-së.

Sa i përket arsyeve të paraqitësit të kërkesës se vendimi i KKPK-së përmban gabime lidhur me sipërfaqen e ngastrave, gjykata nuk gjen këto gabime të pretenduara. Por edhe nëse kanë ndodhur këto gabime, ato nuk paraqesin arsye për të prishur vendimin. Pasi që kërkesa nuk bie në juridiksion të KKPK-së, këto gabime të pretenduara nuk kanë ndikim në aktgjykim, sidomos ato nuk ndikojnë në përmbarimin e tij.

Për shkak të mungesës së juridiksionit, gjykata nuk ka vendosur nëse pala ankuese është ose jo pronar i pronave të kërkuara. Prandaj, vendimi i kësaj gjykate nuk paragjykon vendimin e një gjykate kompetente.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Aneksit III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10,21, dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet në më shumë se € 100,000: € 500 (€ 50 + 0,5% e € 100,000 deri në maksimumin prej 500€).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 parashihet që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

#### **Këshillë juridike**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

***Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX***

***Sylejman Nuredini, Gjyqtar***

***Elka Filchva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it***

***Urs Nufer, Referent i EULEX-it***